



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren — Prizren Belediyesi

Data: 19.06.2023

VERA KULTURORE

Thirrje për shfrytëzimin e shtëpizave të drurit

QËLLIMI

Aktivitetet verore në gjithë botën sjellin atmosferën festive, prandaj dhe në Prizren ashtu siç është bërë traditë tashmë do të organizohen festa të ndryshme nga Komuna e Prizrenit për qytetarët e vendit dhe turistët, gjatë ditëve festive të sezonës së verës. Këto aktivitete ju ofrojnë mundësi bizneseve të vogla të qytetit që të ofrojnë shërbimet e tyre në shesh, në shtëpizat e drurit të cilat do të vendosen në sheshin e Lidhjes.

RREGULLAT E PUNËS

1) Vendi dhe orari i punës

Hapja zyrtare e Festimit të Festave të verës do të bëhet do të bëhet me datën 15.07.2023 (nëse çdo gjë shkon sipas planifikimeve) dhe mbaron me datën 30.07.2023. Të gjithë bizneset e përzgjedhura duhet të respektojnë datat e hapjes dhe mbylljes të përcaktuara nga Komuna e Prizrenit, nëse nuk e respektojnë datën e hapjes, në formë automatike e humbasin të drejtën e shfrytëzimit të shtëpizës.

Gjatë kësaj kohe bizneset e përzgjedhura për shtëpiza obligohen të punojnë çdo ditë, nga e hëna në të dielën duke filluar prej orës 12:00 deri në orën 24:00. Hapja e shtëpizave mund të bëhet më herët, por asnjëherë më vonë se ora e paracaktuar. Çdo biznes që e hap shtëpizën pas orës 12:00, e humbet të drejtën e shfrytëzimit të shtëpizës menjëherë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren — Prizren Belediyesi

Data: 19.06.2023

2) Kriteret e aplikimit dhe operimit

Përzgjedhja e bizneseve të cilat do të shfrytëzojnë shtëpizat do të bëhet nga komisioni në Komunën e Prizrenit.

Numri i shtëpizave do të jetë i kufizuar. Aplikimi i kriterëve si më poshtë do të jetë përcaktues në mënyrë që përzgjedhja e bizneseve të jetë sa më adekuate:

- Bizneset do të aplikojnë për produkte ushqimore, laramani të pijeve si dhe idetë ndryshme të realizueshme me motive verore;
- Bizneset aplikuese duhet të jenë të regjistruara në Administratën Tatimore të Kosovës, me adresë operimi në Komunën e Prizrenit;
- Bizneset aplikuese duhet të paraqesin ofertën me çmimore për artikujt;
- Bizneset e përzgjedhura do t'a kenë obligative që afër shtëpizës t'a kenë shportën për mbeturinat personale;
- Bizneseve të përzgjedhura do t'u lejohen numër i caktuar i shankerica dhe bureve para shtëpizave të tyre;
- Bizneset e përzgjedhura duhet të sjellin deklaratën nga ATK se nuk kanë obligime tatimore të papaguara;

3) Përparësi në përzgjedhje do të kenë

- Bizneset të cilat promovojnë përdorimin e produkteve lokale/vendore;
- Bizneset që ofrojnë produkte ushqimore inovative në fushën e gastronomisë dhe produkte që kanë të bëjnë me motive të stinës së verës;
- Bizneset të cilat dorëzojnë formën e aplikimit të parat që nga data e njoftimit.
- Lokacionet e shtëpizave do të vendosen nga Komuna e Prizrenit, në bazë të planifikimeve për gjithë përfshirje.

4) Kodi mirësjelljes dhe obligimet shtesë

Të gjitha bizneset janë të obliguara të tregojnë frymë bashkëpunimi të mirëfilltë në mes tyre. Në mënyrë që ky bashkëpunim të jetësohet sa më mirë, Komuna e Prizrenit gjatë ditëve të organizimeve obligon bizneset dhe ndalon rreptësisht aktet si më poshtë:

- Kryerjen e akteve të paligjshme dhe të dhunshme brenda zonave; Abuzimin verbal ose fizik të personave



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren — Prizren Belediyesi

Data: 19.06.2023

të cilët përfaqësojnë bizneset shitëse konkurruese, si dine të blerësve apo qytetarëve të tjerë kalimtarë;

- Shitjen e produkteve të cilat nuk janë paraparë të shiten në asnjërën prej shtëpizave.
- Obligohen të gjitha bizneset e përzgjedhura që pas përfundimit të orarit të punës ta pastrojnë shtëpizën e tyre dhe hapësirën rreth tyre; Ankesa e përsëritur dy herë për mos pastrim të hapësirës, përkon me shkëputjen e menjëhershme të marrëveshjes dhe marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të shtëpizës.
- Muzika dhe performancat gjatë gjithë kësaj periudhe do të jetë e organizuar dhe e përbashkët. Muzika dhe performancat individuale të bizneseve në shtëpizat e tyre është e ndaluar rreptësisht.

5) Mënyra e Aplikimit

- Plotësimi i aplikacionit të bashkangjitur.
- Aplikuesit në aplikacion duhet ti bashkëngjisin dokumentet përcjellëse: kopjet e certifikatës së regjistrimit të biznesit, deklaratën nga ATK dhe kopjen e letërnjoftimit të personit që aplikon.
- Aplikuesit për shtëpizat e destinuar për pije të ftohta, të ngrohta dhe ushqime duhet ta dorëzojnë menu të pijeve dhe të ushqimit me çmime,
- Aplikuesit kanë të drejtë aplikimi vetëm një herë me kartelën identifikuese të një personi juridik;
- Afati për aplikim: 20 Qershor 2023 — 27 Qershor 2023 prej orës 08:30 - 15:00, në objektin e Komunës së Prizrenit, tek sporteli i kërkesave, ku çdo aplikim duhet të protokollohet, me emrin “Kërkesë për shfrytëzimin e Shtëpizave për Festat e Verës”.

Data e njoftimit të bizneseve të përzgjedhura: 30.06.2023. Më pas njoftoheni se kur duhet të vini në Objektin e Komunës së Prizrenit për nënshkrimin e kontratës dhe procedurat e mëtejme.

Drejtoreshë e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik

